



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Kom.Dh.Shk.II.nr.836/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhomat e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Saranda Bogaj-Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija -Ymeri dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit “D...” sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Halim Shala, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Drenasit, me seli në Drenas, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.C, për shkak të pagesës së borxhit në shumë të përgjithshme prej 13,083.84€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.484/2019, të datës 23.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.11.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës “Komuna e Drenasit”, me seli në Drenas, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.484/2019, të datës 23.12.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “D...” sh.p.k., me seli në Prishtinë, ashtu që është detyruar e paditura Komuna e Drenasit, me seli në Drenas, që në emër të borxhit për punët shtesë nga kontrata me numër 611-18-107-521, për Ndërtimin e Kapacitetit të Ujësjellësit në Kamenicë paditëses t’ia paguaje shumën prej 13,083.84€ me kamatë në lartësi siç e pranojnë bankat në mjetet e afatizuara për një viti, nga dita e paraqitjes së padisë 26.08.2019 e deri në ditën e pagesës përfundimtarë nen kërcënim të përmbarimit të dhunshëm që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit “D...” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të

paditurës Komuna e Drenasit, me seli në Drenas, me të cilën ka kërkuar që t’ia paguajë borxhin dhe atë 3,000.00€ si punë shtesë për mobilizimin e stafit punues dhe pajisjeve të punës 2,000.00€ si punë shtesë për kontrollimin dhe evidentim të instalimeve nëntokësore në vendin e operimit dhe shumë prej 10,000.00€ për denigrimin të reputacionit ose emrit të mirë të paditëses me kamatë në lartësi siç e pranojnë bankat në mjetet e afatizuara për 12 muaj nga dita e paraqitjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtarë më kërkesë të përmbartimit të dhunshëm. Dhe në pikën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguajë shumë në lartësi prej 598,92€.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Komuna e Drenasit, me seli në Drenas, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e të paditurës, Komuna e Drenasit si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivendosje në pikën I e aktgjykimit V.EK.nr.484/2019 të datës 23.12.2021.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi “D...” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me datën 26.08.2019 ka parashtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë kundër të paditurës Komuna e Drenasit, me seli në Drenas , për shkak të kompensimit të borxhit që rrjedh nga kontrata për “Ndërtimin e Kapacitetit të Ujësjetës në Kamenicë me nr. në vlerën e përgjithshme prej 134,282.55€, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoje kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se paditësi dhe i padituri kanë qene në raport juridiko – detyrimor nga kontrata për Ndërtimin e Kapaciteteve të Ujësjetës në Kamenicë me nr., ku pala paditëse ka pasur rolin e punë kryerësit dhe ka marr detyrimin për kryerjen e punimeve, ndërsa e paditura ka marr obligimin për pagimin për kryerjen e punëve të kontraktuara në shumë e përgjithshme prej 134,282.55€, ku pala paditëse ka filluar kryerjen e punimeve sipas kontratës, ndërsa menaxhere e projektit është caktuar F.K, ndërsa organ mbikëqyrës është caktuar G.K i cili ka pasur për detyrim përcjelljen dhe mbikëqyrjen e punimeve ndërtimore sipas kontratës. Pala paditëse ka pretenduar se ka kryer edhe punime shtesë në shumë prej 13,083.84€, 3,000.00€ për mobilizimin e stafit punues dhe pajisjeve të punës, 2,000.00€ për kontrollim dhe evidentim të instalimeve nëntokësore në vendin e operimit dhe shumë prej 10,000.00€ për denigrim të reputacionit ose emrit të mirë të paditëses dhe se i takon kompensimi në lidhje me këto punime ndërtimore të realizuara. Nga ditari i punës nr.7 të datës 30.11.2018 gjatë daljes në tërën të Drejtorit për infrastrukture I.H dhe Organit Mbikëqyrës G.K është vërtetuar fakti

se të njëjtit kanë urdhëruar paditësen të vazhdojë me plotësimin e gjatësive të gypave 1,400m. Nga kërkesa për aprovimin e punëve shtesë të ushtruar nga Organi Mbikëqyrës është vërtetuar se i lartë cekuri, i është drejtuar menaxheres së kontratës F.K, z.I.H dhe paditëses në të cilën ka deklaruar se kërkesa për punë shtesë është e arsyeshme dhe e domosdoshme për të kompletuar këtë dege të rrjetit që të jetë funksionale, po ashtu ka theksuar se edhe pas daljes në teren në ditarin e punës të datës 30.11.2018 ku kanë parë se për të kompletuar rrjetin duhet të vazhdohet me punët shtesë, ku ka bashkangjitur edhe para masën dhe para llogarinë për punët shtesë të cilat ishin të përshkruara dhe vlera e tyre ishte në shumën prej 13,083.84€. Nga shkresa e datës 04.04.2019 është vërtetuar fakti se Drejtori për infrastrukturë Publike I.H i është drejtuar Zyrës së Prokurimit duke i kërkuar që të fillojnë me procedurën për vazhdimin e projektit për punë të paplanifikuara – punë shtesë për kontratën dhe të cilat punë rezulton të jene miratuar edhe në ditarin e punës me datën 30.11.2018. Nga komunikimet e realizuara në mes të palëve në forme elektronike është vërtetuar fakti se me datën 04.04.2019 menaxherja e projektit F.K përmes email-it zyrtar i është drejtuar paditëses duke e urdhëruar që menjëherë të fillojë me punimet ne projektin Ndërtimi i Kapacitetit të Ujit të pijes në Kamenicë për mungesë të gjatësisë të gypit 0250mm L=310 m’ dhe gypin 0225mm në gjatësi L=50m, për këtë urdhëresë ja njoftuar edhe G.K, I.H. dhe R. LL. Nga kërkesa për pagesën e punëve shtese e datës 23.07.2019 e hartuar nga paditësja për të paditure është vërtetuar fakti se paditësja i është drejtuar të paditurës për pagesën për punët shtesë të kryera sipas para masës dhe para llogarisë. Nga mendimi dhe konstatimi i dhënë nga ana e ekspertit të ndërtimtarisë z. N.M në ekspertizën e datës 17.08.2021 ka deklaruar se kemi të bëjmë me punë të tepruara, për tejkalimin e sasive të kontraktuara ka qene në dijeni Organi Mbikëqyrës edhe para fillimit të ekzekutimit të këtyre punëve (ditari i datës 30.11.2018) ku janë të përshkruara punët e tepërta të cilat nuk janë paguar. Po ashtu ka theksuar se punët të cilat janë kryer janë pranuar nga Komisioni për pranim teknik vëllimi i punëve të tepërta është pranuar nga Organi Mbikëqyrës dhe vlera e punëve të tepërta është në shumën prej 13,083.84. Prandaj, gjykata e shkallës së parë mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8.1, 645, 648 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të atakuar.

Gjykata komerciale si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 8 par.1 të LMD-së, në të cilin përcaktuar se “ *Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit*”. Ndërsa nenin 645 par.1 të LMD-së përcakton se “ *Kontrata për ndërtim është kontratë me të cilën kryerësi detyrohet sipas projektit të caktuar të ndërtojë në afatin e caktuar ndërtesën e*

caktuar në tokën e caktuar, apo në një tokë të tillë respektivisht në objektin tashmë ekzistues të kryejë punë të tjera ndërtimi, ndërsa porositësi detyrohet që për këtë t'i paguajë çmimin e caktuar". Në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi dhe i padituri kanë qenë në raport juridik kontraktues nga kontrata për "Ndërtimin e Kapaciteteve të Ujësjetillës në Kamenicë me nr.661-18-107-521", ku në këtë raport detyrimor paditësi i ka kryer punimet e kontraktuara sipas para masës dhe para llogarisë, ku me datën 30.11.2018 gjatë mbikëqyrjes së punimeve nga Organi Mbikëqyrës në ditarin e punës nr.7 kanë konstatuar pamundësinë e funksionalizimit të projektit sipas para masave bazë tenderuese, ku paditësja në këtë rast si punë kryerëse është urdhëruar për punë shtesë ku ju është llogaritur sasia sipas para masës dhe para llogarisë që punimet ishin në vlerë prej 13,083.84€. Për të vërtetuar dhe sqaruar lartësinë dhe vëllimin e punëve të kryera nga pala paditëse është caktuar eksperti nga lëmia e ndërtimtarisë, ku nga raporti i ekspertizës së datës 17.08.2021 ka konstatuar se në këtë rast kemi të bëjmë me punë të tepruara, për tejkalimin e sasive të kontraktuara ka qene në dijeni Organi Mbikëqyrës edhe para fillimit të ekzekutimit të këtyre punëve (ditari i datës 30.11.2018) ku janë të përshkruara punët e tepërta të cilat nuk janë paguar. Po ashtu ka theksuar se punët të cilat janë kryer janë pranuar nga Komisioni për pranim teknik vëllimi i punëve të tepërta është pranuar nga Organi Mbikëqyrës dhe vlera e punëve të tepërta është në shumën prej 13,083.84. Prandaj, Gjykata Komerciale - dhomat e shkallës së dytë vlerëson se ekziston obligimi i të paditurës që paditësit në emër të punëve shtesë të kryera t'ia paguajë shumën prej 13,083.84€.

Gjykata Komerciale, dhomat e shkallës së dytë vlerëson se e paditura, duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh paditësit për pagesën e punëve të kryera në emër të punëve shtese të paparapara, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit. Sipas Nenit 245 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve "*kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi*", prandaj duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, gjykata e shkallës së parë në bazë të dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, ka vendosur drejtë kur e detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensoj borxhin në shumën e gjykuar.

Gjykata Komerciale- dhomat e shkallës së dytë vlerëson se nga gjendja faktike, sipas pikëpamjes së kësaj gjykate, rezulton se kërkesëpadia e paditësit pjesërisht është e bazuar. Ndërsa e paditura nuk ka paraqitur asnjë provë dhe as nuk ka arritur që ti bëjë të besueshme lidhur me pretendimet e saja, për të cilat pretendon se i padituri në këtë rast nuk kemi dhënë pëlqimin për kryerjen e punimeve të kontraktuara.

Në rastin konkret, me nënshkrimin e kontratës bazë, palët ndërgjyqëse kanë pranuar kushtet e përgjithshme nga kontrata e cila ka qenë bazë për kryerjen e punimeve të caktuara. Pra, për të gjitha ndryshimet që ndodhin gjatë punimeve të kryera, kontraktuesi është i obliguar të njoftojë kontraktuesin tjetër për faktet të cilat janë paraqitur, siç është ndryshimi i projektit, apo paraqitja e punëve shtesë, dhe meqenëse punë kryerësi e ka njoftuar kontraktuesin lidhur me këto punë dhe

në këtë rast nga kërkesa për aprovimin e punëve shtesë të ushtruar nga Organi Mbikëqyrës është vërtetuar së paditësi i është drejtuar menaxheres së kontratës F.K, z. I.H dhe paditëses në të cilën ka deklaruar se kërkesa për punë shtesë është e arsyeshme dhe e domosdoshme për të kompletuar këtë dege të rrjetit që të jetë funksionale, po ashtu pas daljes në terren në ditarin e punës të datës 30.11.2018 ku kanë parë se për të kompletuar rrjetin duhet të vazhdohet me punët shtesë, ku ka bashkangjitur edhe para masën dhe para llogarinë për punët shtesë të cilat ishin të përshkruara ku vlera e këtyre punëve shtese të realizuara do të jetë në shumën prej 13,083.84€.

Gjykata vlerëson se, punimet të cilat paditësi i ka kryer, të njëjtat i ka kryer me pëlqimin e të paditurës përkatësisht nga menaxherja e projektit znj. F.K, e cila përmes email-it zyrtar i është drejtuar paditësit duke e urdhëruar që menjëherë të fillojë me punimet në projektin “Ndërtimi i Kapacitetit të ujit të pijes”, ndërsa e paditura nuk ka provuar faktin se këto punë janë kryer pa pëlqimin e tyre. Pra, paditësi ka ndërmarr veprime për kryerjen e punëve kur e ka marr pëlqimin nga ana e të paditurës.

Kjo gjykate vlerëson se me nenin 648 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se “*Për çdo shmangie nga projekti i ndërtimit respektivisht nga punimet e kontraktuara, kryerësi duhet të ketë pëlqimin me shkrim të porositësit*” ndërsa në paragrafin 2 përcaktohet se “*Ai nuk mund të kërkojë ngritje të çmimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtitillë*”. Në rastin konkret paditësi kishte marr pëlqimin me shkrim të porositësi i punimeve, përkatësisht nga Organi Mbikëqyrës i cili me kërkesën për vazhdimin e punëve shtese kishte njoftuar edhe menaxheren e kontratës dhe të autorizuarit të tjerë sipas kontratës dhe ia kishin bashkangjitur edhe para llogarinë dhe para masën në të cilën ishte cekur sasia e punimeve dhe vlera e tyre. Po ashtu, nga shkresa e datës 04.04.2019 e përfaqësuesit të Drejtoratit Për Infrastrukturë Publike rezulton se i njëjti i është drejtuar Zyrës së Prokurimit duke i kërkuar që të fillojë me procedurën për vazhdimin e projektit për punë të paplanifikuara – punë shtesë për kontratën “Ndërtimin e Kapaciteteve të Ujësjetillës në Kamenicë me nr.”, dhe të cilat punë rezulton të jenë miratuar edhe në ditarin e punës më datën 30.11.2018, po ashtu me datën 04.04.2019 menaxherja e projektit znj. F.K përmes email-it zyrtarë i është drejtuar paditëses duke e urdhëruar që menjëherë të fillojë me punimet në projektin e kontraktuar ku dhe me këtë urdhërese ka njoftuar edhe zyrtarët G.K, I.H dhe R.LI.

Gjykata Komerciale, dhomat e shkallës së dytë vlerëson se po ashtu me nenin 35.2 pika 4(II) të Ligjit për Prokurimin Publik (Ligji nr.04/L-042) e përcakton se “*Autoriteti kontrakturës mund të përdorë procedurat e negociuara tek një kontratë për kryerjen e punëve shtese, nëse ato punë nuk janë parapara me kontratë apo projekt, nëse ato punë janë paraqitur përmes rrethanave të paparashikuara dhe të njëjtat janë të nevojshme për kryerjen e punimeve të përshkruara në projekt*”, ndërsa me nenin 34 të LPP-së është përcaktuar se “*APP-ja mund të autorizojë një autoritet kontraktues që të përdorë procedurat e negociuara, pa publikimin e njoftimit të kontratës*”. Prandaj me këtë rast gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në lidhje me punimet e pa parapara dhe punimet tjera shtese sipas para masës dhe para llogarisë.

Po ashtu në këtë çështje objekt i shqyrtimit ishte është çështja e punimeve të paparapara dhe e punimeve tjera shtesë të pretenduara nga pala paditëse edhe për 3,000.00€ për mobilizimin e stafit punues dhe pajisjeve të punës, 2,000.00€ për kontrollim dhe evidentim të instalimeve nëntokësorë në vendin e operimit dhe shumën prej 10,000.00€ për denigrim të reputacionit ose emrit të mirë të paditëses dhe se i takon kompensimi në lidhje me këto punime ndërtimorë të realizuara, mirëpo kjo gjykatë këto pretendime i vlerëson si të pabazuar, me arsyetimin se pala paditëse nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar pretendimet e saj në lidhje kërkesat e tije, Andaj, kjo gjykatë vlerëson së gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar kur për këto pika e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale- dhoma e shkallës së dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.836/2022**

**KRYETARJA E KOLEGJIT,
Saranda Bogaj -Sheremeti,d.v.**